



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201502403/4

Tiranë ___/___/2016

Lënda : *Rekomandim për zbatimin e Vendimit Nr.5, datë 04.03.2016, të Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Dega Rajonale Tiranë, mbi "Pezullimin plotësisht të aktivitetit" të subjektit juridik Fasoneri "A-C" shpk, për shkak se zhurmat e gjeneruara nga subjekti, janë mbi nivelin e lejuar dhe përbëjnë shqetësim për banorët.*

Drejtuar : **Inspektoriat Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujrave**
Kryeinspektorit
Ministria e Mjedisit

TIRANË

Inspektoriat Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHS)
Kryeinspektorit

TIRANË

Agjencia Rajonale e Mjedisit
Qarku Tiranë
Rruga "Sami Frashëri", Godina nr.4, Kati 2

TIRANË

Njësia Administrative Dajt
Bashkia Tiranë

TIRANË

Policia Bashkiake
Bashkia Tiranë
"Rruga e Kavajës"

TIRANË

Komisariati i Policisë nr.4
Shefit të Komisarariatit

TIRANË

Të nderuar zotërinj,

Në ankesën drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasia A.H, në emër dhe të banorëve të pallatit në Rrugën "Muhamet Deliu", në zonën e "Freskut", Tiranë, ka ngritur shqetësimin lidhur me nivelin e lartë të zhurmave

mbi kufitë e lejuar, të shkaktuara nga makineritë e një Fabrike Fasonerie “A-C” sh.p.k, e cila kryen aktivitetin e saj tregtarë jo afër por brënda ambienteve të banimit, pikërisht në katin e parë të këtij pallati, si dhe mungesën e reagimit të institucioneve shtetërore për parandalimin e kësaj situatë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, nisur nga dokumentacioni i depozituar nga ankuesi konstaton se, shqetësimi i banorëve ka qënë objekt i ankesave që prej vitit 2013 e në vazhdim, drejtuar strukturave shtetërore të ngarkuara me ligj, me qëllim marrjen e masave për parandalimin dhe zhdukjen e efekteve të zhurmave të krijuara nga zhvillimi i aktivitetit nga subjekti i lartëpërmendur, brënda ambienteve të banimit. Por, pavarësisht ankimeve reagimi i institucioneve shtetërore ka qënë inekzistent. Ankuesja shprehet se, situata e nivelit të zhurmave jo vetëm që vijon të jetë e njëjtë, por duke qënë se, subjekti juridik Fasoneri tashmë punon 24 orë pa ndërprerje, situata është rënduar për banorët, si pasojë e ndikimit negativ të shkaktuar nga niveli i lartë i zhurmave të krijuar nga makineritë, kompresorët dhe puna e njerëzve në fabrik.

Lidhur me këtë situatë, për shkak dhe të ankesave të vazhdueshme të banorëve, në muajin dhjetor 2015 ka reaguuar Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Dega Rajonale Tiranë, e cila me shkresë nr.1203/3 prot., datë 14.12.2015, bazuar në Ligjin nr.9774, datë 12.07.2007 *“Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”*, është drejtuar Institutit të Shëndetit Publik (ISHP), Tiranë, si njësi bazë e referencës për kryerjen e matjeve, monitorimin dhe vlerësimin e zhurmave, për kryerjen e matjeve të nivelit të zhurmave të shkaktuara nga subjekti Fasoneri “A-C” sh.p.k, si dhe pajisjen me kopje të këtij dokumentacioni për efekt inspektimi.

ISHP-ja në përgjigjen e saj me shkresën nr.1654/1, datë 01.03.2016, pasi ka kryer ekspertizën e nivelit të zhurmave ka arritur në përfundimin se, *“...aktiviteti i fasonerisë rrit nivelin e zhurmës në ambientet e brëndshme të banimit...niveli fon i zhurmës i matur në banesë, krahasuar me nivelin e zhurmës që gjenerohet nga “A-C” sh.p.k, është 5 – 6 dB (decibel) më i lartë, pra aktiviteti i mësipërm përbën shqetësim tek banorët....”*

Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Dega Rajonale Tiranë, pasi është vënë në dijeni të konkluzionit të raportit të ISHP-së, në cilësinë e një prej organeve të kontrollit të parashikuar për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, bazuar në autorizimin e inspektimit lëshuar më datë 03.03.2016, me nr.435/2 prot., si dhe aktit të ekspertizës të nivelit të zhurmave të kryer nga ISHP-ja, ka kryer inspektimin pranë këtij subjekti dhe në prezencë të Administratorit të personit juridik “A-C” sh.p.k, ka mbajtur dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Proces – verbalin “Për inspektimin” (nr.serie 0017951), datë 04.03.2016, në zbatim të nenit 45, të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 *“Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”*, të nenit 30, të Ligjit nr.9774, datë 12.07.2007 *“Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”*;

2. Proces – verbalin “Për konstatimin e kundravajtjeve administrative” (nr.serie 0002465), datë 04.03.2016, në zbatim të pikës “a”, të nenit 6, pikës 1, të nenit 7, të Ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, dhe të pikës 1, të nenit 31, të Ligjit nr.9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”;

Nga ku rezulton se, “...zhurma e shkaktuar nga aktiviteti i lartpërmendur është tej normave të lejuara dhe krijon shqetësim tek banorët gjatë orëve 06⁰⁰–22⁰⁰ të ditës dhe të mbrëmjes, si dhe përbën kundërvajtje administrative...”.

Në vijim të ushtrimit të kontrollit të parashikuara në ligj, mbi veprimtarrinë e personit juridik “A-C” sh.p.k, grupi i Inspektimit të ISHMPU-së, Dega Rajonale Tiranë, me Vendim “Për dënim Administrativ”, (nr.serie 0002000), nr.5, datë 04.03.2016, në mbështetje të nenit 48, Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe në zbatim të pikës 1/e, të nenit 32, të Ligjit nr.9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, për shkak se, veprimtaria e subjektit juridik “A-C” sh.p.k përbën kundërvajtje administrative, **ka vendosur:**

1. Të dënojë me gjobë në vlerën 10. 000 (dhjetë mijë) lekë
2. Të pezullojë plotësisht aktivitetin;

Sipas dokumentacionit shoqërues, institucioni përgjegjës për ushtrimin e këtij kontrolli, ISHMPU-ja, Dega Rajonale Tiranë me shkresë nr.435/3 prot., datë 04.03.2016, pasi ka vënë në dijeni subjektin e kontrolluar, në mbështetje të nenit 31, pika 2, të Ligjit nr.9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, ku thuhet shprehimisht se: “...2. Në rast kundërshtimi për zbatimin e masave të mësipërme, bashkëpunohet me Policinë e Shtetit dhe me policinë e bashkisë/komunës...”, ka njoftuar Komisaratin e Policisë nr.4, Tiranë dhe Policinë Bashkiake, Tiranë, për të bashkëpunuar me qëllim pezullimin e këtij aktiviteti. Por, për shkaqe të pamotivuara ligjore, ky vendim ende dhe sot, nuk është zbatuar nga strukturat shtetërore të ngarkuara me ligj.

Referuar kërkesave të ligjit, për zbatimin e Vendimit “Për dënim Administrativ”, nr.5, datë 04.03.2016 të ISHMPU-së, ngarkohet me përgjegjësi ligjore edhe organi i qeverisjes vendore, konkretisht Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë, e cila sipas nenit 8, të Ligjit nr.9774, datë 12.07.2007, ka për detyrë të hartojë dhe zbatojë planet vendore të veprimit për zhurmën, të miratuara më parë nga këshilli bashkiak, por njëkohësisht të kërkojë nga personat fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari apo përdorin impiante dhe instalime që lëshojnë zhurmë, “...marrjen e masave parandaluese për respektimin e vlerës kufi të zhurmës, si dhe ju kërkojnë organeve të kontrollit të

ushtrojnë kontroll, të bëjnë matje dhe të pezullojnë apo të mbyllin veprimtari, që nuk respektojnë dispozitat e këtij ligji...”.

Përgjegjësia e organeve të qeverisjes vendore qëndron dhe në rastin e dhënies të lejes të shfrytëzimit të objektit. Ato kanë për detyrë, të kryejnë verifikimin e zbatimit të kërkesave të ligjit, në objektet në ndërtim apo dhe rikonstruksionit të ndërtesave për banim, me qëllim që zhurma në brendësi apo në afërsi të saj, të jetë brenda nivelit kufi. Këto organe verifikojnë zbatimin e ligjshmërisë edhe kur objekti bën ndryshim destinacioni të përdorimit të ndërtesës, i cili duhet të shoqërohet nga ana e përdoruesit të objektit, me masa mbrojtëse nga zhurma për respektimin e vlerës kufi.

Po ashtu, në vijim të përgjegjësisë ligjore që ka organi i qeverisjes vendore, Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë, me vënie në dijeni nga ana e subjektit ankues, duhet të ushtronte kontrole dhe mos të lejonte kryerjen e veprimtarisë të subjektit Fasoneri brenda ambienteve të banimit. Konkretisht pika 4, të nenit 18, të Ligjit nr.9774, datë 12.07.2007, parashikon se: “Në territorin e Republikës së Shqipërisë janë të ndaluara: *...Instalimi dhe funksionimi, në katet përdhese të ndërtesave të banimit, i veprimtarive të punimit të drurit, të metaleve....e veprimtarive të tjera, të ngjashme me to, që lëshojnë zhurmë mbi nivelin kufi për mjediset e banimit...*”

Sa më sipër, bazuar në dokumentacionin shoqëruar që ankuesja ka vënë në dispozicion të Avokatit të Popullit, konstatojmë se këto kompetenca të përcaktuara në ligj, nga organi i qeverisjes vendore Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë, nuk janë zbatuar, e cila me veprimet dhe mosveprimet e saj ka lejuar zhvillimin e veprimtarisë nga subjekti Fasoneri i lartëpërmendur, duke shkaktuar zhurma tej normave të lejuara, si dhe për pasojë ka sjellë ndikim negativ dhe përkeqësim të situatës për banorët që jetojnë në të njëjtin pallat me të.

Në këto kushte, Avokati i Popullit nisur nga shqetësimi i qytetarëve i krijuar nga zhurmat mbi normën e lejuar mbi 5 – 6 dB (decibel) të shkaktuara nga puna dhe makineritë e Fabrikës të Fasonit brenda ambienteve të banimit të pallatit, mungesa e reagimit në kohë të institucioneve shtetërore të ngarkuara me ligj për mos lejimin e ushtrimit të veprimtarisë të këtij subjekti në këto ambiente banimi, si dhe për parandalimin e një situatë konfliktuale mes qytetarëve që banojnë në këtë ambient banimit dhe përfaqësuesve të subjektit privat, me qëllim mbrojtjen e një mjedisi të shëndetshëm, të jetës dhe pronës për qytetarët, konsiderojmë të mbështetur në ligj veprimin e organit të administratës publike, ISHMPU, Dega Rajonale Tiranë, në marrjen e Vendimit “Për dënim Administrativ”, (nr.serie 0002000), nr.5, datë 04.03.2016, ndaj personit juridik “A-C” sh.p.k.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe në përputhje me pika “b”, të nenit

21, të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se: *“Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit.....,*

- *paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,*

REKOMANDOJMË:

Fillimin e procedurës administrative për zbatimin e Vendimit “Për dënim Administrativ”, (nr.serie 0002000), nr.5, datë 04.03.2016, të ISHPMU-së, Dega Rajonale Tiranë, sipas kontrollit të ushtruar për veprimtarinë e personit juridik “A-C” sh.p.k, për nivelin e lartë të zhurmave të makinerive tej normave të lejuar, duke shkaktuar shqetësime për banorët e pallatit në Rrugën “Muhamet Deliu”, në zonën e “Freskut”, Tiranë, në të cilin është vendosur:

1. *Të dënojë me gjobë në vlerën 10. 000 (dhjetë mijë) lekë*
2. ***Të pezullojë plotësisht aktivitetin;***

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë kopjen e Vendimit “Për dënim Administrativ”, (nr.serie 0002000), nr.5, datë 04.03.2016, të ISHPMU-së, Dega Rajonale Tiranë, ndaj subjektit juridik “A-C” sh.p.k.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj,

KOMISIONERE

Etilda GJONAJ(SALIU)